

Përgjigjet e mija në 40 pyetjet e gazetarit Enver Robelli (botuar në "Kohën Ditore", më 7 dhe 8 qershor 2012)

1. Në cilin vend dëshironi të jetoni në hapësirën e banuar me shqiptarë?

Unë jam i lumtur që jam banor i Prishtinës, por edhe në Tiranë e Shkup besoj se do të kaloja mirë. Mua më pëlqejnë qytetet që janë pakëz më të mëdha, ku ka më shumë mundësi, më shumë zgjedhje, edhe pse nganjëherë raportet ndërnjerëzore në këto vende mund të depersonalizohen, d.m.th. mungon ngrohtësia e qyteteve të vogla. Kuptohet, Prishtina, Tirana e Shkupi janë qytete të mëdha për trevat shqiptare, por përndryshe edhe këto qytete vuajnë nganjëherë nga mentaliteti provincialist.

2. Cilin personalitet të historisë shqiptare do të dëshironit ta takonit sikur të ishte e mundshme?

Faik Konicën, i cili ka qenë një polimat modern, i rrallë ndër ne.

3. Çka do ta pyetnit së pari?

Cili do të ishte inkurajimi i tij për t'u marrë me politikë? Mos të harrojmë, në vitin 1901, në një këshillë një të riu që dëshironte të botonte një gazetë shqip, ndër të tjera, Konica shkruante: *"Në mos shkroftesh për politikë, do të thonë se s'është koha të punojmë për letratyrë, kur vendi ndodhet në rrezik; në shkroftesh për politikë do të thonë se prishë punë duke egërsuar qeverinë."* Natyrisht, për mua është e qartë se gjërat nuk ndërrohen vetvetiu, dhe thënien e Havelit e trajtoj si postulat: *"Nëse jeni modest dhe nuk jeni të etur për fuqi, jo vetëm që ju përshtatet politika, por ju absolutisht e keni vendin aty."*

4. Cili është personaliteti më i rëndësishëm historik për ju?

Unë hezitoj në përcaktimin e një hierarkie të tillë, por sidoqoftë po e përmendi Euklidin, sepse di që disa lexues mund të kenë dëgjuar më pak për të, e mendoj se ia vlen të dihet për punën e tij jashtëzakonisht me rëndësi. Euklidi ka qenë një matematikan në Greqinë antike, i cili njihet për autorësinë e 13 vëllimeve të librit "Elementet". Edhe pse materia që ai e kishte shtjelluar nuk ishte tërësisht origjinale, por përmbledhte edhe kontribute të filozofëve të tjerë, "Elementet" konsiderohet ndër librat më me ndikim të të gjitha kohërave. Libri i Euklidit është studiuar ose është përdorur si tekst mësimi në mënyrë të vazhdueshme, që nga shekulli i tretë para erës sonë, e deri në kohërat moderne. Me ribotimet e tij për një periudhë aq të gjatë, vetëm dy libra fetarë i bëjnë rivalitet për kah numri i ribotimeve.

5. A ekziston Zoti?

Varet nga përkufizimi që jepet. Sidoqoftë, përveç që mendoj se duhet respektuar të drejtën e besimit, unë mendoj se besimi i cili e forcon paqen, mirëkuptimin ndërmjet njerëzve dhe lirinë e tyre, është i dobishëm. Në këtë frymë, edhe unë besoj, dhe kam respekt të thellë për ata që me devotshmëri i kryejnë ritet e veta fetare.

6. Cilin libër po e lexoni aktualisht?

Do të flas për romane se përndryshe do t'i mërzisja lexuesit tuaj. Këto ditë po e lexoj veprën "Norwegian Wood" të autorit japonez Haruki Murakami. Ajo është një prozë letrare e shkruajtur jashtëzakonisht bukur dhe ku shtjellohen, në mes të tjerash, dilemat e përzgjedhjes në dashuri të një të riu. Në fakt, para Murakamit e pata lexuar një vepër të Mishimas, poashtu autor japonez. Kjo është pjesë e përpjekjeve të mia që të mësoj më shumë për kulturat e vendeve të ndryshme. Pas Azisë do të kaloj tek vendet arabe, për të dalur në vendet e Afrikës. Unë mendoj se krahas vizitave fizike, njoftimi përmes letërsisë me vendet e ndryshme është mjaft i dobishëm për ta shtuar mirëkuptimin në mes të popujve, si dhe për ta zgjeruar imagjinatën dhe shtuar kreativitetin e lexuesit.

7. Cilin qytet të ish-Jugosllavisë keni dëshirë ta vizitoni?

Do të doja ta vizitoja Sarajevën. Nuk kam qenë asnjëherë në qytetin që vuajti aq shumë gjatë viteve të 90-ta dhe që u shndërrua në simbol të nivelit ekstrem të së keqes që mund t'i shkaktojnë njerëzit njëri-tjetrit kur udhëheqen nga urrejtja, por edhe në simbol të mposhtjes së kësaj të keqe, nga dëshira më e madhe e një populli për të qenë i lirë, e ndihmuar nga vetëdijësimi i vonuar i Perëndimit për rëndësinë e intervenimit në anën e së mirës.

8. Kur keni udhëtuar për herë të parë jashtë shtetit dhe në cilin vend keni qenë?

Udhëtimi im i parë i vërtetë, i planifikuar, dhe ku kam shkuar vetëm, ka qenë në Paris, në tetor 2001. Atje kam qëndruar për një muaj, për t'i bërë vizitë disa universiteteve dhe institucioneve të arsimit atje. Si rezultat i asaj vizite, jo vetëm që Parisin tash e kam në zemër, por mendoj se kam përfituar shumë edhe në botëkuptimet e mija në përgjithësi, edhe jashtë lëmenjve që kam studiuar. Vetëm kalimi nga njëra anë e lumit Seine në anën tjetër i hap disa horizonte që nuk hapen lehtë përndryshe, dhe unë kam qenë me fat që kam qëndruar në Paris disa herë, në perioda më të gjata, që prej vitit 2001, deri në vitin 2010 kur kam qëndruar rreth tetë muaj.

9. Kur keni qenë për herë të parë në Shqipëri?

Kam qenë në vitin 2001. Më kujtohet që rruga Prizren-Tiranë ka qenë ende në gjendje të mjerueshme dhe edhe pse shkova nëpërmjet transportit rrugor, u ktheva në Prishtinë

nëpërmjet atij ajror. Tash është përmirësuar shumë infrastruktura, që është një element i rëndësishëm i komunikimit të natyrshëm të Kosovës me Shqipërinë.

10. Çfarë do të ishte për ju fatkeqësia më e madhe?

Humbja e shpresës.

11. Cilin shkrimtar të huaj e pëlqeni më së shumti?

Veprat e Nabokov-it më pëlqejnë jashtëzakonisht. Aftësia e tij që të prodhojë vepra të një kualiteti të lartë në anglisht, edhe pse ai kishte shkruar një mori librash rusisht, në gjuhën e tij amtare, e bëjnë shkrimtarin edhe më të veçantë.

12. Kultura e cilit vend perëndimor ju pëlqen më së shumti?

Kam respekt të madh për kulturën amerikane, e cila u ndërtua mbi kulturën evro-perëndimore.

13. Cili emër ju pëlqen më së shumti?

Para disa ditësh e dëgjova emrin Perla, i cili më pëlqeu mjaft. Sa për emrat e meshkujve, Adri është emri i nipit tim (si dhe i një mikut tim të mirë) e më duket që unë jam përgjegjës për emrin e nipit (por jo të mikut), andaj po e veçoj këtu.

14. A është mëkat të jesh homoseksual?

S'është mëkat të jesh as aseksual, as heteroseksual, as biseksual e as homoseksual. Është e drejtë themelore e të rriturve të përcaktohen se me cilët të rritur dëshirojnë të afrohen, emocionalisht apo fizikisht, me miratimin e dyanshëm. Statistikisht, nuk ka popull të pastër apo të papastër në këtë aspekt, andaj më së miri do të ishte nëse fokusohemi tek problemet e vërteta: ekonomia, shëndetësia dhe arsimi, sesa të humbim kohë me urrejtjen e pakicave, të çfarëdo natyre qofshin ato. Zgjidhja e këtyre problemeve duhet të na bëjë bashkë, e nuk duhet të merremi me çështje që vetëm na ndajnë dhe nuk na lejojnë ta arrijmë progresin e nevojshëm.

15. A do të ishit i gatshëm të luftoni në rast se rrezikohet liria e vendit?

Po. Ne duhet ta ndërtojmë një shoqëri ku nuk ka nevojë të ketë sakrifikime kapitale, por në të njëjtën kohë nuk duhet të frikësohemi të jemi të lirë dhe të sakrifikojmë për liri. Përndryshe, Kosova e njuh rolin e individit nga historia e vet, rolin e atyre që u burgosën politikisht, rolin e atyre që u flijuan për Kosovën dhe rolin e të tjerëve që u angazhuan në shumë forma për lirinë e vendit tonë. Të gjithëve që u flijuan, u munduan, dhe kontribuan për lirinë e vendit tonë, si qytetar i Kosovës, si shqiptar, u jam shumë mirënjohës. Tashmë, fatbardhësisht, është koha kur

askush, sidomos nga klasa politike, nuk duhet të sakrifkohet, përveçse në qoftë se sakrificë quhet humbja e privilegjeve të fituara pa meritë. Kosova, me mjaft mundime, e ka kaluar periudhën e dhunës frontale nga jashtë. Tash duhet ta kalojmë edhe periudhën e frikësimit nga brenda. Prandaj, është e nevojshme të fillohet hapja e një kaptine të re, e cila fillon me konsolidimin e demokracisë. Liritë dhe vlerat individuale janë bazë e atyre shoqërore.

16. Cilin person s' do të kishit dëshiruar ta takoni kurrë?

Nuk e kam problem ose frikë të takohem me askë.

17. A duhet të bashkohen Kosova dhe Shqipëria?

Me një fjalë, po. Por, në një botë reale në të cilën jetojmë, duhet gjejmë formën e duhur të bashkimit. E bashkimi nuk bëhet as me folk-patriotizëm e as me anti-patriotizëm, por me patriotizëm të mençur, modern, dhe që i respekton të drejtat e të gjithë qytetarëve, pa dallim etnie, e që nuk e definon çdo problem të brendshëm si të shkaktuar nga dikush që nuk është shqiptar. Bashkëpunimi i natyrshëm dhe shkëmbimet me Shqipërinë nuk mund të zëvendësojnë defiçencat evidente të demokracive, ekonomive dhe funksionimeve shtetërore të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës. Pa marrë parasysh ato, duhet të ketë thellim të bashkëpunimit dhe koordinimit në të gjitha sferat në mes të dy shteteve shqiptare, për t'i kontribuar paqes, stabilitetit dhe prosperitetit në regjion, si dhe bashkimit të popujve evropianë.

18. A është dëmtuar dialekti gegë me standardin gjuhësor të vitit 1972 dhe a duhet të ndryshohet ky standard?

Edhe mund të jetë dëmtuar, por ky nuk është justifikim i faktit se në Kosovë (sikurse në Shqipëri) ka probleme thelbësore me shkrim-lexim, madje edhe në nivelin universitar. Standardi i unifikuar i shqipes i ka kontribuar bashkimit, instensifikimit dhe efikasitetit të komunikimit, si dhe shkëmbimeve të shqiptarëve. Si rrjedhojë, gjuha jonë ka arritur nivel më të lartë. Standardizimi në asnjë vend nuk është proces i mbaruar, por që evoluon vazhdimisht. Standardizimi nuk e përjashton pasurimin e gjuhës, i cili patjetër ndodh, edhe kur kjo certifikohet ose jo nga gjuhtarët. Edhe pse nuk do të ishim populli i parë nëse vendoset të krijohen dy standarde të së njëjtës gjuhë për të njëjtin popull (p.sh. norvegjezët janë një popull i tillë), mendoj se idetë e tilla janë humbje kohe dhe kundërproduktive për ne.

19. Cilit komb dhe cilës kulturë do t'i kishit takuar me qejf?

Kuptohet, jam shumë i lumtur që jam shqiptar. Por, me qejf do të isha edhe nga Singapori. Arsyeja është si vijon: Edhe pse një shtet me territor të vogël dhe pa resurse natyrore, Singapori

radhitet në majat e zhvillimit në botë. Prej vitit 1965 deri në vitin 2011, GDP-ja per capita e Singaporit është ngritur nga rreth 500 në mbi 50 000 dollarë amerikanë. Një rritje e tillë nuk ka qenë e rastësishme – Singapori njihet për investimin në arsim dhe në forcën punëtore. Sipas një studimi të OECD (Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim), vendet me më pak resurse natyrore, si Singapori, kanë dalur më së miri në testet e standardizuara të studentëve, kurse ato me resurse të mëdha kanë dalur më së keqi. Në Kosovë mund të mësojmë shumë nga ky vend aziatik i vogël, por me ndikim. Për këtë, duhet të shikojmë përtej idesë se kinse jemi të pasur me resurse por nuk po na lënë rehat të tjerët. Mund të përparojmë si shoqëri vetëm nëse marrim përgjegjësi për veprat dhe përzgjedhjet tona.

20. Sikur të kishit pushtetin politik çfarë do të ndryshonit së pari?

Do ta ndryshoja mënyrën aktuale të qeverisjes. Për shembull, nga 19 ministri do t'i bëja 9 dhe nga 6 zv.kryeministra do ta bëja 1. Nëse qeveritë me radhë kanë prodhuar të këqija elementare për qytetarë dhe nëse duam ta zvogëlojmë të keqen, atëherë duhet ta zvogëlojmë dhe jo vetëm ndryshojmë përbërjen e Qeverisë. Nuk është vetëm çështja e shpenzimeve të parave të qytetarëve, tuajat, tonat, që vjen me një numër aq të madh ministrish, por *sjellja shoqërore* të cilën ato shpenzime e kushtëzojnë dhe krijojnë. Nuk bëhet fjalë për ndryshimin e totalitetit të shoqërisë, por për krijimin e një mase kritike për ndryshime. Sjellja korruptive nxit abuzime dhe papërgjegjësi, për shembull, edhe në institucione të tjera shtetërore e publike, në kohën kur vendit i duhet përgjegjësi dhe llogaridhënie. Na duhet përgjegjësia e votuesve për ta dëshmuar nevojën e tyre për ndryshime transformuese, pa marrë parasysh manipulimet zgjedhore, dhe na duhet përgjegjësia e të votuarve, pa marrë parasysh trysninë eventuale ndërkombëtare. Dhe, përfundimisht, secili që ka integritet, kompetencë dhe vizion duhet të merret me politikë, jo pse politika është e lehtë, por pse jeta e qytetarëve është rënduar për shkak të politikës shkurtpamëse dhe të dëmshme.

21. Cili është personi më i rëndësishëm për ju?

Unë kam mësuar se më së lehti është nëse nuk bëj dallime ndërmjet anëtarëve të familjes, andaj dallimin nuk do ta bëj as në këtë rast. Po e theksoj se pjesë të familjes, ose anëtarin më të re, e kam edhe të fejuarën, Jetën, dhe shumë afër në hierarkinë e të rëndësishmëve i kam edhe shoqërinë e ngushtë.

22. Cilën apo cilat gazeta të përditshme i lexoni?

“Zërin”, “Kosovën Sot”, “Kohën Ditore”, por edhe të tjerat i shfletoj me shpejtësi për t’u informuar se çka po na shërbehet si informatë nga redaksitë dhe gazetarët. Unë e respektoj shumë profesionin e gazetarëve, sidomos në kushtet e vështira të funksionimit në Kosovë,

mirëpo me ngulm kërkoj që niveli i ulët i politikës të mos përcjellet ose raportohet nga i njëjti nivel i gazetarisë.

23. Cila ngjyrë ju pëlqen më së shumti?

E kaltra.

24. Cila lule ju pëlqen më së shumti?

Trëndafilat.

25. Cilin virtyt tuajin e çmoni më së shumti?

Këtë ua lë të tjerëve për ta përcaktuar. Unë mendoj se duhet që në mënyrë konstante ta kërkojmë ameliorimin e vetes, të vetes gjithmonë imperfekte.

26. Cilat virtyte i çmoni te një grua?

Maturinë, drejtësinë, guximin dhe qëndrueshmërinë.

27. Cilat virtyte i çmoni te një burrë?

Njësoj si për gratë.

28. Cilin politikan të kohës së Jugosllavisë e vlerësoni më shumë?

Më së shumti i vlerësoj ata që u munduan ta ndryshojnë sistemin jugosllav, i cili i diskriminonte shqiptarët. Ka edhe të tillë që kanë kontribuar mjaft "breda" sistemit, por kontributi i tyre është i vobekët në krahasim me ata të që u burgosën politikisht për shkak se qëndronin në mbrojtje të të drejtave të shqiptarëve. Qëndresën e Bacës Adem, z. Adem Demaçi e vlerësoj më së shumti.

29. Cilin politikan të Kosovës pas vitit 1989 e vlerësoni më shumë?

Respektin më të madh e rezervoj për Ukshin Hotin. Z. Hoti, edhe pse nuk u lejua që të jetë aktiv në politikë nga Serbia sepse e dinte vlerën e shtuar që do ta sillte inkuadrimi i tij aktiv në politikë, arriti që të artikulojë pozicione, kërkesa dhe rrugëdalje në mënyrën që asnjë politikan tjetër i yni nuk arriti. Është për keqardhje se një pjesë e izolimit të z. Hoti u shkaktua nga një pjesë e elitës politike kosovare e cila ndihej komod nën nënshtrim dhe ndihej vet e vogël, andaj edhe e rrezikuar, përball madhësisë intelektuale të z. Hoti, i cili nuk pranonte nënshtrimin.

30. Cilin politikan të Republikës së Shqipërisë në këto 20 vitet e fundit e vlerësoni më shumë?

Nuk do e dalloj ndonjë. Megjithatë, dëshiroj të potencoj se përkundër progresit evident të shënuar në 20 vitet e fundit në Shqipëri, klasa politike atje, si tërësi, nuk ka arritur ta realizojë as misionin e marrë nga qytetarët e Shqipërisë e as të arrijë pritjet e shqiptarëve dhe miqve kudo që ndodhen, për një Shqipëri më të avancuar ekonomikisht, me një demokraci të konsoliduar dhe me zbatim adekuat të rendit e ligjit. Stagnimi në rrugën drejt BE-së është shembull ekstrem i paaftësisë së asaj klase që t'i kontribuojë edhe forcimit të Kosovës përmes forcimit të shtetit të Shqipërisë.

31. A ka Enver Hoxha ndonjë meritë për Kosovën?

Nuk ka dyshim se Enver Hoxha ishte një diktator dhe se mungesa e lirive e izolimi i Shqipërisë i solli dëm qytetarëve të Republikës së Shqipërisë dhe shqiptarëve jashtë këtij territori. Edhe nëse diktatori Hoxha e udhëheqte shtetin ku shqipja flitej lirshëm, fjalët në shqip dhe kuptimi i tyre nuk ishin të lira. Por, natyrisht se shteti shqiptar ka plot merita për zhvillime pozitive në Kosovë. Besoj se në Kosovë, sikurse nuk duhet t'i akuzojmë ata që ishin pro një regjimi të cilin nuk e njihnin, tash kur e dimë shumë mirë tmerrin që përjetuan vëllezërit në Shqipëri, nën atë regjim, nuk duhet të ngurrojmë t'i dënojmë ato akte ç'njerëzore. Nuk është arsyetim i diktaturës as frika e as sistemi politik. Duhet të mësojmë nga e kaluara, edhe pse, natyrisht, pa e përbuzur ndonjë kontribut ose meritë të saj.

32. A ka Josip Broz Tito ndonjë meritë për zhvillimin politik, arsimor, ekonomik dhe kulturor të Kosovës?

Nuk mund të kem dhe nuk kam nostalgji për ish-Jugosllavinë. Përveç diskriminimit famëkeq të shqiptarëve, natyrisht se ka pasur edhe zhvillime pozitive, por ato duhet të krahasohen me mundësitë e humbura e jo me stadin zero ku e kanë lënë me qëllim Kosovën për një kohë të gjatë udhëheqësit jugosllavë, përfshirë diktatorin Tito.

33. Cili është për ju personaliteti më i urreyer historik?

Nuk kam hierarki urrejtjesh, por në krye padyshim do të ishte Hitleri, për shkallën e urrejtjes dhe planifikimit, si dhe urdhërimin e ekzekutimit të krimeve me përmasa të papara nga bota.

34. Sikur të kishit jetuar në Luftën e Dytë Botërore a do t'iu kishit bashkuar lëvizjes partizane në luftë kundër pushtimit nazist?

Nuk ka qenë vetëm lëvizja partizane alternativë kundërshtuese e nazizmit. Duhet theksuar se liria e një populli nuk duhet ndërtuar duke sakrifikuar lirinë e një populli tjetër dhe pa marrë para sysh se ishte e orientuar direkt apo jo kundër shqiptarëve një makineri ushtarake

gjenocidiale, nuk ka dyshim se do të isha kundër nazizmit sepse ajo ishte e keqe botërore që shkaktoi vuajtje të përmasave globale të papara më herët dhe të cilat duhet kujtuar gjithmonë.

35. Cili është intelektual i më i madh i Kosovës?

Kam shumë respekt për akademik Rexhep Qosjën. Edhe nëse nuk pajtohem me të në një mori çështjesh, tek e fundit kjo nuk duhet kërkuar asnjëherë në raport me askë, fakti se opinioni i tij është gjithmonë i rëndësishëm tregon se ai e ka arritur një nivel që asnjë intelektual tjetër në Kosovë nuk e posedon. Unë me shumë vëmendje i lexoj mendimet e shkruara dhe të thëna të akademik Qosjes.

36. Cili është shkrimtari më i madh shqiptar?

Sikurse për shumëkë, edhe për mua shkrimtari i preferuar shqiptar është Ismail Kadare. Ai ka arritur që romanin shqiptar ta ngrejë në majat e letërsisë botërore – kjo është fjali e thjeshtë për veprën e madhe të z. Kadare.

37. Cili është aktori/aktorja më e madhe shqiptare?

Kam respekt të jashtëzakonshëm për të arriturat e Bekim Fehmiut, kurse ndër aktoret e reja e veçoj me kënaqësi Arta Dobroshin.

38. A keni marrë pjesë në ndonjë demonstratë?

Jo. Kur bëheshin demonstratat në vitet 90-ta unë kam qenë shumë i ri për të marrë pjesë në ato. Të gjitha përpjekjet e mija janë të drejtuara për të demonstruar fuqishëm, për ta kundërshtuar në mënyrë konstruktive udhëheqjen korruptive, shtypjen e lirisë dhe dinjitetit të qytetarit dhe shtetit të Kosovës, duke dhënë alternativë konkrete për demokraci, liri kolektive dhe të individit, përfshirë mundësitë ekonomike, si dhe drejtësi. Kjo është politika e së ardhmes, e cila nuk do të bëhet vetvetiu nëse shumica rrinë duarkryq. Ne duhet ta zhvillojmë atë, qoftë edhe përmes demonstratave, për një të ardhme më të ndritur.

39. A është toleranca fetare mes shqiptarëve mit apo realitet?

Është realitet relativ i cili duhet kultivuar në vazhdimësi dhe posaçërisht duhet ruajtur nga sulmet që vijnë nga ekstremistët dhe sharlatanët.

40. Cila është ëndrra juaj më e madhe?

Ëndrra ime konvergjon me ëndrrën tonë të përbashkët, për të cilën punuan shumë breza, e që sot po vihet në rrezik nga disa. Është ëndrra për një vend të lirë e në paqe me veten dhe me fqinjët, i cili u mundëson të rinjve dhe të vjetërve, grave e burrave, të ëndërrojnë lirishëm dhe

ta rimarrin dinjitetin e humbur, pa dallim përkatësie farefisnore, rajonale apo partiake. Është ëndrra e dymve të hapura të prosperitetit e jo ajo që ia kthen shpinën shpresës. Ëndrra e ndërtimit dhe jo ajo e shkatërrimit. Është ëndrra e mundësive dhe jo ajo e kufizimit. Është ëndrra të cilën mund ta bëjmë realitet së bashku.